REZOLUTË
PËR KORRIDORIN E 8-TË

a) Duke vlerësuar lart rëndësinë e madhe të Korridorit të 8-të Paneuropian të transportit në zhvillimin e lidhjeve dhe bashkëpunimit të gjithanshëm të vendeve dhe popujve të Europës Juglindore, Italisë, BE-së e më gjerë;

b) Duke konsideruar se ky Korridor Intermodal Paneuropian u referohet porteve, rrugëve, hekurudhave, aeroporteve dhe infrastrukturës së transportit të kombinuar dhe multimodal, duke përfshirë instalime ndihmëse, si rrugët hyrëse, pikat e kalimeve kufitare, stacionet e shërbimit, terminalet e pasagjerëve dhe të mallrave, magazinat dhe instalimet e nevojshme dhe menaxhimin e trafikut etj.;

c) Duke mbështetur kontributin e çmuar të Italisë, SHBA-së dhe vendeve të tjera perëndimore për të çuar përpara këtë projekt;

ç) Duke njohur impaktin e veçantë të këtij Korridori përsa i përket krijimit të një klime të re europianizuese dhe integruese në Gadishulin Ballkanik dhe në mbarë Europën Juglindore;

d) Duke e vlerësuar ndërtimin e Korridorit të 8-të si një shans historik dhe si momentin e një ndryshimi të rëndësishëm për Shqipërinë dhe për vendet e tjera të rajonit;

dh) Duke konsideruar ndryshimet pozitive në strukturën dhe efikasitetin e transporteve dhe telekomunikacioneve në të gjithë hapësirën e Korridorit, si dhe përfitimet evidente për të gjitha vendet përkatëse;

e) Duke mbështetur Memorandumin e Mirëkuptimit për Zhvillimin e Korridorit të 8-të të Ministrave të Transportit të Italisë, Shqipërisë, Maqedonisë, Bullgarisë, Turqisë dhe Greqisë të datës 9 shtator 2002 në Bari të Italisë;

ë) Duke mbështetur deklaratën e këtyre ministrave në përfundim të mbledhjes së datës 31 mars 2004 në Tiranë, ku i kërkohet Parlamentit Europian dhe Komisionit Europian përfshirja e projektit të Korridorit të 8-të në listën e projekteve prioritare në kuadrin e programeve të investimeve në të ardhmen e afërt;

f) Duke vlerësuar Memorandumin e Mirëkuptimit për Zhvillimin e Korridorit të 8-të nga Paneuropian në Transkontinental, të nënshkruar nga ministrat e Shqipërisë, të Maqedonisë, të Bullgarisë, të Turqisë dhe të vendeve të Trans-Kaukazisë në shtator 1997 në Varna të Bullgarisë;

g) Duke vlerësuar studimet dhe projektet për portet e Durrësit dhe të Vlorës në funksion të konsiderimit të Shqipërisë si urë transiti e transportit Lindje-Perëndim dhe Perëndim-Lindje;

gj) Duke mbështetur e inkurajuar të gjitha nismat dhe kontributet e institucioneve shqiptare, politikanëve shqiptarë, shoqërisë civile, sipërmarrjes së lirë, grupeve të ndryshme të interesit dhe individëve të lirë në funksion të zhvillimit të Korridorit të 8-të;

h) Duke pohuar faktin se segmenti shqiptar përbën kushtin e ekzistencës dhe identitetin e Korridorit të 8-të;

i) Duke shprehur shqetësimin:

- për stadin e progresit të projekteve të fazës së dytë të zhvillimit të Korridorit të 8-të në territorin e Republikës së Shqipërisë, sipas studimeve Bechtel dhe Gibb;

- për vonesën në zbatimin e vendimit të Qeverisë për transferimin nga porti i Durrësit të depozitave të disa shoqërive të importit të naftës, si një nevojë për t'u hapur rrugën investimeve të mëtejshme në kuadrin e Korridorit të 8-të dhe si një domosdoshmëri për ruajtjen e jetës së banorëve nga një rrezik eventual;

- për mungesën e investimeve private në projektet e Korridorit të 8-të;

- për pengesat dhe vështirësitë që hasin qytetarët dhe transportuesit shqiptarë në përdorimin e infrastrukturës ekzistuese të Korridorit, për shkak të mungesës së marrëveshjeve dypalëshe dhe shumëpalëshe që lehtësojnë kalimet kufitare në veçanti,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

1. I kërkon Qeverisë, që në përputhje me angazhimet e palës shqiptare në Memorandumin e Barit (shtator 2002), si dhe duke reflektuar zhvillimet aktuale dhe perspektive në lidhje me Korridorin e 8-të:

a) vendosjen e Korridorit të 8-të Paneuropian si një prioritet absolut i strategjisë dhe politikave të transportit në Republikën e Shqipërisë;

b) fillimin e punës brenda vitit 2005 për përgatitjen e studimeve dhe projekteve për fazën e dytë të zhvillimit të Korridorit në territorin e Shqipërisë;

c) të konsiderojë mundësinë e krijimit brenda vitit 2004 pranë Ministrisë së Transporteve të një strukture të posaçme të Korridorit të 8-të me detyra të karakterit nxitës, koordinues dhe ekzekutiv të përcaktuar qartë;

ç) të vlerësojë nevojën e një ligji të posaçëm për Korridorin e 8-të, në të cilin, duke konsultuar përvojën e vendeve të tjera të Korridorit, të gjejë shprehje ligjore përcaktimi, gjurma si dhe çështje të tjera të rëndësishme të zhvillimit të Korridorit të 8-të;

d) të rrisë efikasitetin negociues të diplomacisë shqiptare për të lidhur marrëveshje që përmirësojnë lëvizjen e lirë të njerëzve përgjatë Korridorit, lehtësojnë kalimet në pikat kufitare dhe rrisin aksesin e operatorëve të transportit për përdorimin e infrastrukturës respektive;

dh) të shtojë nismat dhe të forcojë lobingun brenda grupit BE dhe SHBA për të argumentuar dhe nxitur financimin e projekteve të Korridorit në Shqipëri;

e) të shqyrtojë me përgjegjësi të gjitha studimet dhe propozimet e specialistëve dhe grupeve të ndryshme të interesit në Shqipëri për projektet e Korridorit dhe zhvillimin e tij si një Korridor i fuqishëm transiti; të nxisë një angazhim më të madh të ekspertëve shqiptarë në këtë drejtim;

ë) të sigurojë pjesëmarrje sa më të madhe të sektorit privat në ndërtimin dhe përdorimin e Korridorit, duke siguruar në të njëjtën kohë transparencë maksimale për progresin, projektet, diskutimet, vendimmarrjen dhe oponencën.

2. U bën thirrje dhomave të tregtisë dhe industrisë, organizatave të sipërmarrjes së lirë, në veçanti atyre të ndërtimit, organizatave të shoqërisë civile të orientohen me përparësi në punën e tyre drejt problematikave dhe projekteve të Korridorit të 8-të.

U bën thirrje partive dhe organizatave politike, Shoqatës së Kryetarëve të Bashkive dhe institucioneve të tjera shtetërore të nxisin dhe të mbështesin ndërtimin e shpejtë të Korridorit të 8-të në Shqipëri.

Tiranë, më 29 korrik 2004